



Kuvendi Komunal / Skupština Opštine / Muncipal Rahovec

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2 pika d dhe nenit 14, paragraf 1,2 dhe 3, nenit 17 pika (c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës nr. 03/L-40, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15 qershor 2008), të nenit 7, paragrafi 3të Ligjit nr. 04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr.35/17, dhjetor 2012), nenit 2 dhe 5 të Statutit të Komunës së Rahovecit, 01Nr.569/1 i dt. 16.12.2010, propozimit të Kryetari i Komunës se Rahovecit nr. 274 të dt. 10.06.2016, si dhe kërkesës për rishqyrtim të MAPL-së datë 29.07.2016 Nr.020-997/4, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 19 Gusht 2016, miraton këtë:

VENDIM

- I. Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës, me nr. protokollit 274 të dt. 10.06.2016 për miratimin paraprak të vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim personave fizik/juridik.
- II. Sipas vendimit të cekur në pikën I, pronat e paluajtshme në vijim do të jepen në shfrytëzim:
 1. Parcela kadastrale, nr. P-71510057-02891-1, në sipërfaqe të përgjithshme prej 5081m2, pronar PSH e Kosovës, K.K. Rahovec, që gjendet në vendin e quajtur Kuqisht, zona kadastrale Rahovec.
 2. Parcela kadastrale, nr. P-71510057-03871-0 në sipërfaqe të përgjithëshme prej 2767m2, pronar PSH e Kosovës, K.K.Rahovec, që gjendet në vendin e quajtur Rimnik, zona kadastrale Rahovec.
 3. Parcela kadastrale, nr. P-71510057-03870-0 në sipërfaqe të përgjithshme prej 3308m2, pronar PSH e Kosovës, K.K. Rahovec, që gjendet në vendin e quajtur Rimnik, zona kadastrale Rahovec.
 4. Parcela kadastrale, nr. P-71510057-0 në sipërfaqe të përgjithshme prej 3093m2, pronar PSH e Kosovës, K.K. Rahovec.
- III. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës të cekur në pikën II të këtij vendimi është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale gjithsesi është edhe interes publik për zhvillimin e bujqësisë dhe ekonomisë, si dhe tu jepet mundësi qytetarëve të vetëpunësohen.
Me të hyrat nga prona e dhënë në shfrytëzim ose rritja e aseteve ekzistuese (përmirësimi i infrastrukturës rreth pronës së Komunës), ndihmohet në rritjen e vlerës së asaj prone.
- IV. Afati kohor për dhënien e pronës të paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën II sipas këtij vendimi është afatshkurtër në periudhën prej dhjetë(10) vitesh.

- V. Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër realizohet përmes ankandit publik.
- VI. Të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe përfituesit të pronës së dhënë do të rregullohen me kontratë të veçantë të nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe përfituesi i marrjes në shfrytëzim të pronës së paluajtshme në periudhën afatshkurtër.
- VII. Komisioni për vlerësimin e ofertave bënë të gjitha përgatitjet për mbajtjen e ankandit publik sipas Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, Nr.04/L-144, Rregullores së QRK-së Nr.23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme komunale, i cili komision përgatit kushtet për mbajtjen e ankandit dhe përcakton kriteret në njoftim duke përfshirë çmimin fillestar, afatin e dhënies në shfrytëzim, lokacionin si dhe kriteret tjera të përcaktuara në Ligj dhe Rregullore.
- VIII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset: Komisioni vlerësues për dhënien e pronës, së paluajtshme të Komunës, Kryetari i Komunës.
- IX. Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë që ta bëjë regjistrimin e pronës së paluajtshme në regjistrin kadastral konform legjislacionit në fuqi.
- X. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në Web – faqen zyrtare të Komunës së Rahovecit.

Me vendim të njoftohen:

1. Kryetari i Komunës,
2. Komisioni,
3. MAPL,
4. DGJKP, dhe
5. Arkivi.

KUVENDI I KOMUNËS SË RAHOVECIT

01.Nr. 2579

Rahovec, 19.08.2016



Kryesuesi i Kuvendit

Nahit Elshani

